

24 shtator 2014

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Qyteti është hapësirë e përbashkët e të gjitha gjinive

EC Ma Ndryshe ka vijuar me ciklin e debateve "Planifikim urban me pjesëmarrje". Qëllimi i këtyre debateve është prezantimi i të gjeturave të fokus grupeve me shtatë grupe të komunitetit në Prizren për identifikimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve në raport me planifikimin urban.

Në debatin e djeshëm "Gratë dhe planifikimi urban në Prizren" u prezentuan të gjeturat kryesore nga fokus grupet e mbajtura me komunitetin e grave, problemet dhe kërkesat e dalura nga këto diskutime. Panelistë të debatit ishin Shpresa Osmanollaj nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Prizrenit dhe Rozafa Basha nga EC Ma Ndryshe.

Para të pranishmëve u prezentuan edhe rezultatet nga anketa e fundit me 300 respondentë në Prizren mbi perceptimin e qytetarëve për planifikimin urban. Në të gjeturat kryesore nga anketa me qytetarët e gjinisë femrore të Prizrenit me një përqindje të lartë prin bllokimi i trotuareve me makina. Shqetësuese për gratë mbeten aktivitetet e ndërtimeve pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet dhe mungesa e parqeve publike.

Gratë e punësuar, përfaqësues të OJQ-ve që merren me të drejtat e grave, kryefamiljaret, dhe pjesëmarrësit e tjerë në këtë debat kanë shprehur shqetësimin e tyre për pjesëmarrjen jo-aktive të gruas në procesin e planifikimit urban. Numri i vogël i grave pjesëmarrëse është diskutuar të jetë shqetësim kryesor për mos identifikimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Ndaj përfaqësuesve të komunës së Prizrenit është kërkuar që të shqyrtohen qështjet të cilat kanë dalur si më kryesore nga fokus grupet e organizuara me gratë. Siguria në rrugë, mungesa e infrastrukturës shëndetësore dhe asaj rrugore janë ngritur sérish si pika diskutimi. Nga gratë pjesëmarrëse është kërkuar që të punohet në drejtim të ndriqimit të rrugëve, lirimit të trotuareve dhe mirëmbajtjes së hapësirës publike. Gjendja e varrezave të qytetit dhe ndriçimi i rrugëve janë cilësuar si dy qështjet më shqetësuese për grate e pranishme.

Cikli i debateve do të vazhdojë me debatin e radhës, që mbahet më 01 tetor 2014 në Prizren, ku fokusi i diskutimit do të jetë mbi nevojat e të rinjtëve të Prizrenit në raport me planifikimin urban.

Me respekt,
Flaka Xërxa, koordinatore projekti
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr.Saraqët 5, 20000 Prizren
+381 38 224 967 & +381 29 222 771
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
flaka.xerxa@ecmandryshe.org

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center që përkrahet nga Qeveria e Suedisë



OJQ EC Ma Ndryshe ~ Rr. Saraqët 5, Prizren ~ Rr. Zeki Shulemaja 2, Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038 224 967 & 029 222 771